Sot ne daten 13.9.1993, para meje noteres mu paraqiten personalisht palet e mesiperme: Zeqiria Abazi, banues ne Tetove dhe Bardhyl Canaj, banues ne Tirane, me Nr. pasaporte perkatesisht, 1. 2109954400 dhe 2. A2 090449, per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet e tyre personale madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar te cilet me deklarun se sa me sipër eshte nje statut i SHPK "RIO-FARM", i redaktuar jashte kesaj zyre por me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe une noterja e vertetoj ate rregullisht konform ligjit.




NOTERE
(chikuroze Sokolli)
[Signature]

6684/1

S M Dajpo
03 03 10 2003
03 TETOR 2003

KERKESE



KERKUESI:

Z. Bardhyl Canaj, shtetas shqiptar, i biri i Nimetit dhe I Vergulles, lindur me 29 Gusht 1959 ne Tirane, banues ne adresen Rruga "Abdyl Frasherit" Pall. 9, shk. 4, Ap. 34, Tirane, ne cilesine e Administratorit te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K.

OBJEKTI:

Depozitimin e Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K., date 29.09.2003.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 7638, date 28 Nentor 1992, "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligji Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare".

Per kompetence

**Gjykates se Shkalles se Pare Tirane
Seksionit Tregtar**

Shoqeria RIO-FARMA SH.P.K. eshte peson juridik shqiptar i regjistruar me Vendimin nr. 6684 date 23.09.1993 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Objekti i veprimtarise se shoqerise "RIO-FARMA" Sh.P.K. eshte si me poshte:

- Tregtimi me shumice dhe prodhimi i medikamenteve farmaceutike, import dhe eksport i tyre, paisje dhe instrumenta medicinale, sanitare, ushqime dietale per femije.

Selia e shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K. ndodhet ne adresen: Rruga "A. Frasherit" Pallati nr. 9 Shk. 4 Ap. 43, Tirane Shqiperi.

Kapitali i shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K. eshte 10.000 USD (dhjete mije dollare amerikane).

Ortaket e shoqerise jane Z. Zeqirija Abazi i cili zoteron 90% te kapitalit fillestar dhe Z. Bardhyl Canaj i cili zoteron 10% te kapitalit fillestar.

Me date 29.09.2003, me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, ortaket e kesaj shoqerie kane vendosur:

1. Futjen ne shoqeri te ortakëve te rinj te cilet jane trashegimtare te ish-ortakut Z. Zeqirija Abazi. Ortakëve te rinj te shoqerise jane Znj. Luljeta Abazi dhe Zamira Abazi. Pas vleresimit te kapitalit qe do te bejne ekspertet Luljeta Abazi dhe Zamira Abazi do te trashegojne ne pjese te barabarta pjesen qe i takonte trashegimlensit Zeqirija Abazi Ortaku tjetër i shoqerise mbetet Z. Bardhyl Canaj. Pjeset perkatese te kapitalit e ri qe do te zoteroje secili ortak do te jene:

- a) Z. Bardhyl Canaj do te zoteroje 50% te pjeseve te kapitalit te ri.


14

- b) Znj. Luljeta Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri.
 - c) Znj. Zamira Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri.
2. Emerimin e administratorit te ri. Qe nga ky moment administrator i vetem i shoqerise do te jete Z. Bardhyl Canaj.
 3. Te pasqyrohet rritja e kapitalit ne natyre dhe ne te holla duke e rregjistruar ate ne baze te raporteve te hartuara nga ekspertet.
 4. Emerimin e ekspertit kontabel dhe te ekspertes se vleresimit te pasurive te palujtshme te cilet do te bejne vleresimin e kapitalit dhe pjeset qe i takojne secilit ortak ne kete kapital . Si eksperte emerohen:
 - d) Z. Ferdinand Nishani, shtetas shqiptar, i biri i Dautit, me datelindje me 27.03.1959, me vendlindje ne Kucove, banues ne Tirane, me titullin Ekspert Kontabel i Autorizuar, me nr. Licence 96, i cili do te beje vleresimin e rritjes se kapitalit ne te holla.
 - e) Znj. Lirije Kruja, shtetase shqiptare, vleresuese e shkalles se pare, me Licence Nr. SVP 0053, inxhinier ndertimi, e cila do te beje vleresimin e rritjes se kapitalit ne natyre.
 5. Te pasqyrohen ndryshimet e bera ne nenet e statutit nga kjo assemble e jashtezakoneshme e ortakeve. Pra te behen ndryshimet e nevojeshme perkatesisht ne nenet; 5, dhe 14 te statutit.
 6. Ndryshimin e selise ne adresen: Rruga e Saraceve, P. 112/1, Tirane, Shqiperi.

Ne perfundim, une Kerkuesi ne cilesine e Administratorit te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K. ne baze te Ligjit Nr. 7638, date 28 Nentor 1992, "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare", kerkoj qe te behet depozitimi i Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K., date 29.09. 2003, ne Zyren e Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, duke kryer te gjitha ndryshimet perkatese.

KERKUESI

Bradhyl Canaj



15

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 4709 Rep.

VERTETIM

Sot me daten 03 . 10 . 2003 para meje Liri Gjoliku, notere prane Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalisht perpara meje :

Bardhyl Canaj, shtetas shqiptar, i biri i Nimetit dhe I Vergulles, lindur me 29 Gusht 1959 ne Tirane, banues ne adresen Rruga "Abdyl Frasheri" Pall. 9, shk. 4, Ap. 34, Tirane, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ne cilesine e administratorit te shoqerise 'Rio-Farma' shpk, i cili me deklaroi se sa me siper eshte nje kerkese drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare Tirane per depozitimimin e Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "Rio-Farma" SHPK, e hartuar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe Une, Noterja, e vertetoj ate rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

LIRI GJOLIKU

dy.

REPUBLIKA E MAQEDONISË

Taksat sipas tarifës nr. 1 dhe 11
të ligjit për taksa administrative,
është paguar dhe asgjësuar në kërkesë

**CERTIFIKATË
NGA LIBRI AMZ I TË VDEKURVE
Komuna SHKUP**


Në librin amzë të të vekuqe që evidentohen për vendin SHKUP, është regjistruar, nën
Nr. rendor 3108 të vitit 2002 vdekja e:

| | | | |
|---|---------------------------------|---|----------------------|
| Emri | ZEQIRIJA | | gjinija |
| Mbiemri | ABAZI | | Mashkull |
| Dita, muaji, viti dhe ora e vdekjes | 30/tridhijeti/Gusht 2002 | | |
| Vendi i vdekjes | Shkup | | |
| Dita, muaji dhe viti i lindjes i të ndjerit | 21 Mars 1945 | | |
| Vendi i lindjes | Tetovë | | |
| Shtetësia | R. Maqedonisë | Nr. amzë | 2103945470012 |
| Vendbanimi i fundit dhe adresa | Tetovë, | | |
| Gjendja civile | I martuar | | |
| Mbiemri para kurorizimit | --- | | |
| Emri dhe mbiemri i bashkëshortit/es para kurorizimit | Luljeta Abazi lind. Paloshi | | |
| Emri dhe mbiemri | I ati | Husein Abazi | |
| i prindërve | E ëma | Saide Sulejmani | |
| Vërejtje: | / | | |
| Nr. 2011-3071 15.11.2002 Shkup | (Vula) | nënshkrim i palexueshëm Nënshkrim i ofiqarit Snezhana Dobrevska | |

Gjykata themelore Tetove

Vertetohet se perkthimi nga maqedon shtet
ne shqip eshte bere drejt.
Nr. 1688/2002
Vendi/Data: Tetovo 29.11.2002
Perkthyes: S. Xhater

S. Xhater



ОСНОВЕН СУД ТЕТОВО

Тврдам дека правилно го извршив
преводот од албански на
македонски јазик..
Бр. 1688 /2002
Место/дату:Тетово, 29.11. 2002 год
Преведувач: Сеадин Џафери

Seadin Džafari

**NOTERE
LIRI GIOLIKU
TETOVE**

L. Gioliku

18

Gjykata Themelore në Tetovë, si Gjykatë e shkallës së parë për trashëgimi me gjykatësin Safet Hamzi, duke shqyrtuar trashëgimin e të ndjerit Zeqirija Abazi, ish nga Tetova në seancën e mbajtur më 25.12.2002 në datim me 2003 nga ZVP, mori këtë:

VENDIM

GJYKATA THEMELORE NE TETOVE
Ky Vendim është i plotësisht i përbërë nga 28.02.2003, nënshkrimi i pallexueshëm
Vullë e rrumbullakët zyrtarë Gjykatës Themelore në Tetovë

PER TRASHËGIMTAR/E LIGJOR/E të Zeqirija Abazit, i vdekur më 30.08.2002 në Shkup, me vendbanim të fundit në Tetovë, shtetas i RM-së i cili pas vdekjes së tij ka lënë pasuri të patundshme, dhe atë:
1/5 nga KP nr. 6946 në vendin e quajtur Dereboj, kopsht perimesh, klasit të parë me sipërfaqe prej 10003m2 sipas listës poseduese nr. 4251 në KO Tetovë,
1/3 nga KP nr. 6362 në vendin e quajtur Kuponik, vreshtë klasit dytë me sipërfaqe prej 924m2 sipas listës poseduese nr. 820 në KO Tetovë,
KP nr. 7518/1 në vendin e quajtur Dereboj, kopsht perimesh, klasit të dytë me sipërfaqe prej 4313m2 sipas listës poseduese nr. 9262 në KO Tetovë,

Si dhe pasuri të tundëshme: Shoqëri për prodhim, qarkullim dhe shërbime, Eko-Frm Zeqirija dhe tj. SHPK Tetovë me seli në Rr. „Gj. Stojceski“ Nr. 36/a, numër i shtresës regjistruese 02007984-3 91-000 si dhe Firmë Ordinancë shëndetsore – Apotekë Medika Tetovë me seli në Rr. „J. Sandanski“ pn, me numër të shtresës regjistruese 1-22251-0-0-0 si dhe llogari devizore në Bankën kreditore SHA Shkup Nr. 6010022326 dhe numër të kartelës 2103945470012, llogari devizore në Tutunska/Duhani/ Bankën SHA, Shkup nr. 72710-9003873, llogari devizore Visa kartelë të Bankës Ekonomike SHA Shkup, Filiala Tetovë nr. 727040280-117-50 si dhe kartela të Diners Klub International me nr. 363334119080002324 dhe nr. 440548280750136095 si dhe kartelë çeqesh të Bankës Ekonomike SHA Shkup me numër serik 0000672 dhe nr. të llogarisë rrjedhëse 923-60 si dhe Automjet udhëtarësh Hyundai Akcent me numër të motorit G4EKR247075, viti i prodhimit 1996.

Vlera e trashëgimisë kap shumën prej 150.000 den. Në bazë të Ligjit

SHPALLEN

Pjesëmarrset Ljuljeta Abazi, bashkëshortja e të ndjerit dhe Zamira Abazi, e bija e të ndjerit nga Tetova, Rr. 185 Nr. 10 secila nga 1/2 (një gjysëm ideale) nga trashëgimia e të ndjerit.

Trashëgimtarët janë përgjegjëse edhe për borxhet eventuale e të ndjerit si dhe të paguajnë taksën për trashëgiminë brenda 15 ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Arsyetimi

Pas procedurës së inicuar për proces trashëgimie për trashëgimin e të ndjerit Zeqirija Abazi, ish nga Tetova Gjykata konstatoi gjendjen faktike si vijon:

I ndjeri Zeqirija Abazi, vdiq në Shkup më 30.08.2002, ai jetoi në Tetovë, pas vdekjes së tij si trashëgimtar të rendit të parë trashëgues ai ka lënë bashkëshorten Ljuljeta dhe të bijat Sehide, Ljaura dhe Zamira të gjitha Abazi nga Tetova, dhe pasuri të tundëshme dhe të patundëshme siç është përshkruar në dispozitivin e këtij vendimi.

Në lidhje me trashëgimin të cilën e la pas vete in ndjeri, në prçesverbal para kësaj Gjykate pjesëmarrsja Ljuljeta personalisht për vete dhe si tutor ligjor për të miturën, të bijën Zamira Abazi dha deklarata pozitive për trashëgimin kurse pjesëmarrset Sehide Abazi dhe Laura Abazi personalisht për vete dhnë deklarata negative për trashëgiminë dhe nuk pranuan të jenë trashëgimtare të trashëgimisë e cila konform Ligjit ju takon.

2

Në gjendje kur i ndjeri nuk ka lënë testament ose kontratë për përmbajtje të përjetëshme, Gjyqi vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Vendosur në Gjykatën Themelore në Tetovë nën O Nr. 561/02 me 25.12.2002v.

GJYKATËSI,
SAFET HAMZI, d.v.
Saktësinë e përshkrimit e vërteton
Drejtuasi i arkivës së Gjykatës
nënshkrimi i pallexueshëm

KËSHILLË: Kundër këtij Vendimi mund të bëhe ankese Në afat prej 8 ditësh nga pranimi i të njëjtes
Nëpërmjet kësaj Gjykate deri te Gjykata e Apelit në Shkup.

Vullë e rrumbullakët zyrtarë e Gjykatës Themelore në Tetovë, R. e Maqedonisë


Me këtë vërtëtohet saktësia dhe tërësia e përkthimit nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe.

Nr. 251-02/03

Vendi/Data: Tetovë, me 28.02.2003

Përkthyes i gjykatës,

Muharem RUFATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

NOTERIA TIRANE

Vërtetohet në

me 28.02.2003

NR 4753 RRE

10.10.2003

19

**VENDIM I ASAMBLESE SE JJASHTEZAKONESHME ORTAKEVE TE SHOQERISE
"RIO-FARMA" Sh. P. K.**

Sot me date 29.09. 2003 u mbledh asambleja e ortakeve te shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K.

Shoqeria RIO-FARMA Sh.P.K. eshte peson juridik shqiptar i regjistruar me vendim nr. 6684 date 13.09.1993 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Objekti i veprimtarise se shoqerise RIO-FARMA eshte si me poshte:

- Tregetimi me shumice dhe prodhimi i medikamenteve farmaceutike, import dhe eksport i tyre, paisje dhe instrumenta medicinale, sanitare, ushqime dietale per femije.

Selia e shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K. ndodhet ne adresen: Rruga "A. Frasheri" Pallati nr. 9 Shk. 4 Ap. 43, Tirane Shqiperi.

Kapitali i shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K. eshte 10.000 USD (dhjete mije dollare amerikane).

Ortaket e shoqerise jane Z. Zeqirija Abazi dhe Z. Bardhyl Canaj.

Administrator i shoqerise eshte Z. Zeqirija Abazi.

Pasi u konstatua pjesmarja e ortakeve si dhe e perfaqesuesve te tyre (trashegimtareve ligjore) mbledhja e Asamblese se jashtezakonshme u quajt e hapur. Mbledhjen e jashtezakonshme te asamblese se ortakeve e drejtoi Z. Bardhyl Canaj. Ai kishte njoftuar me pare ortakun tjetër per rendin e dites i cili ishte njohur me te.


Rendi i dites eshte si me poshte:

- 1) Futja ne shoqeri e ortakeve te rinj te cilet jane trashegimtar te ortakut Z. Zeqirija Abazi.
- 2) Rritja e kapitalit te shoqerise.
- 3) Emerimi i eksperteve te cilet do te vleresojne rritjen e kapitalit te shoqerise
- 4) Zgjedhja e nje administratori te ri te shoqerise.
- 5) Ndryshimi I selise se shoqerise.

Pasi u njohen me rendin e dites te pranishmit filluan diskutimet per cdo pike te tij.

Diskutime rreth pikes se pare te rendit te dites.

Keshtu drejtuesi i mbledhjes Z. Bardhyl Canaj foli ne lidhje me rregullimin e ortakerise pas vdekjes se njerit prej ortakeve Z. Zeqirija Abazi. Ne baze te ligjit per shoqerite tregetare nr 7638 date 19.11.1993 neni 46 dhe Statutit te shoqerise neni 10 pas vdekjes se ortakut pjesen e tij e trashegojne trashegimtarete e tij ligjore te cilet do te futen ne kete shoqeri si ortake. U tha se ortakut i shoqerise Z. Zeqirija Abazi i cili ka vdekur do te zevendesohet ne shoqeri nga e shoqja e tij Znj. Luljeta Abazi dhe nga vajza e tij Zamira



Abazi. Dy vajzat e tjera te ketij ortaku nuk do te marrin pjese ne shoqeri pasi ato kane hequr dore nga trashegimia. Trashegimtarja dhe njekohesisht ortakja e re e shoqerise Znj. Luljeta Abazi eshte kujdestarja ligjore e ortakes Zamira Abazi. Ne keto kushte ortakja Luljeta Abazi do te veproje si perfaqesuese ligjore ne shoqeri e ortakes tjeter Zamira Abazi.

1. Fakti qe bashkeshortja dhe vajza e mitur jane trashegimtare ligjore dhe qe dy trashegimtares e tjere kane hequr dore vertetohet me deshmime e trashegimise me nr 561 date 28.02.2003. Ne keto kushte do te ndryshohet neni 5 i Statutit ku tashme do te jene tre ortake.

Diskutime ne lidhje me rritjen e kapitalit te shoqerise:

Nga ana e ortakut Z. Bardhyl Canaj u paraqit para ortakeve te rinj gjendja reale e shoqerise dhe kapitali real i saj. Ky kapital tashme nuk eshte me 10.000 USD ose 1.000.000 leke sa eshte vene ne fillim por eshte shume here me i madh. Shoqeria duhet patjeter te rrise kapitalin e saj duke e rregjistruar ate.

Me rritjen e kapitalit dhe kontributi i vene nga te dy ortaket ka ndryshuar ai ishte bere tashme 50% per secilin nga ortaket. Ortaket bien dakorte qe te rrisin kapitalin e shoqerise si ne natyre dhe ne te holla. Kapitali I ri I shoqerise do te paqyrohet ne ndryshimet qe do ti behen nenit 5 te statutit.

Pjeset e kapitalit qe do te zoterohen nga secili ortak do te jene ne perputhje me kontributin e tyre ne kapitalin e ri te shoqerise. Keshtu meqenese kontributi I ish-ortakeve tashme ishte bere 50% per secilin prej tyre, ortaket e rinj do te zoterojne perkatesisht:

1. Znj. Luljeta Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri.
2. Znj. Zamira Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri.
3. Z. Bardhyl Canaj do te zoteroje 50% te pjeseve te kapitalit te ri.

Per rritjen e kapitalit te shoqerise ortaket rane dakorte qe te caktojne dy eksperte, nje ekspert kontabel te autorizuar dhe nje ekspert per vleresimin e pasurive te palujtshme te cilet me raportet e tyre perkatese do te percaktojne sa eshte kapitali real i shoqerise dhe do te percaktojne kontributet e secilit ortak ne kete kapital.

Diskutime ne lidhje me piken e katert te rendit te dites :

Gjithashtu u diskutua se nen keto kushte te reja shoqeria duhet te zgjedhe nje administrator te ri te saj, i cili do te zevendesoje ish-administratorin Z. Zeqirja Abazi. Pavaresisht se ne aktet e shoqerise administrator ishte Z. Zeqirja Abazi, ortaku tjeter Z. Bardhyl Canaj deri tani kishte vepruar me detyren e administratorit. Keshtu qe ortaket rane plotesisht dakorte qe administrator i shoqerise qe nga ky moment te jete Z. Bardhyl Canaj duke u bere ndryshimi ne nenin 14 te Statutit te shoqerise.

Diskutime per ndryshimin e selise se shoqerise:

Ortaket e shoqerise vendosen qe tani e tutje selia e shoqerise do te jete ne adresen: Rruga "Saraceve" (Shenisi Dishnica), Pall. 112/1, Tirane, Shqiperi.

22

Pas diskutimeve te mesiperme dhe duke mos patur ceshtje te tjera per te diskutuar ortaket e shoqerise:

VENDOSEN

1. Futjen ne shoqeri te ortakeve te rinj te cilet jane trashegimtare te ish-ortakut Z. Zeqirija Abazi. Ortake te rinj te shoqerise jane Znj. Luljeta Abazi dhe Zamira Abazi. Pas vleresimit te kapitalit qe do te bejne ekspertet Luljeta Abazi dhe Zamira Abazi do te trashegojne ne pjese te barabarta pjesen qe i takonte trashegimlensesit Zeqirija Abazi. Ortaku tjetër i shoqerise mbetet Z. Bardhyl Canaj.
Pjeset perkatese te kapitalit e ri qe do te zoteroje secili ortak do te jene:
 - a) Znj. Luljeta Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri.
 - b) Znj. Zamira Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri.
 - c) Z. Bardhyl Canaj do te zoteroje 50% te pjeseve te kapitalit te ri.
2. Emerimin e administratorit te ri. Qe nga ky moment administrator i vetem i shoqerise do te jete Z. Bardhyl Canaj.
3. Te pasqyrohet rritja e kapitalit ne natyre dhe ne te holla duke e rregjistruar ate ne baze te raporteve te hartuara nga ekspertet.
4. Emerimin e ekspertit kontabel dhe te eskpertes se vleresimit te pasurive te palujtshme te cilet do te bejne vleresimin e kapitalit dhe pjeset qe i takojne secilit ortak ne kete kapital . Si eksperte emerohen:
 - a) Z. Ferdinand Nishani, shtetas shqiptar, i biri i Dautit, me datelindje me 27.03.1959, me vendlindje ne Kucove, banues ne Tirane, me titullin Ekspert Kontabel i Autorizuar, me nr. Licence 96, i cili do te beje vleresimin e rritjes se kapitalit ne te holla.
 - b) Znj. Lirije Kruja, shtetase shqiptare, vleresuese e shkalles se pare, me Licence Nr. SVP 0053, inxhiniere ndertimi, e cila do te beje vleresimin e rritjes se kapitalit ne natyre.
5. Te pasqyrohen ndryshimet e bera ne nenet e statutit nga kjo asamble e jashtezakoneshme e ortakeve. Pra te behen ndryshimet e nevojshme perkatesisht ne nenet; 5, dhe 14 te statutit.
6. Ndryshimin e selise ne adresen: Rruga e Saraceve, P. 112/1, Tirane.
Shoqeria nuk ben ndryshime te tjera te cilat mbeten sic kane qene.

Pasi nuk pati ceshtje te tjera per te diskutuar ortaket vendosen depozitimin e ketij Vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane dhe e deklaruan mbledhjen e mbyllur.

ORTAKET E SHOQERISE RIO-FARMA SH.P.K

LULJETA ABAZI

L. Abazi


ZAMIRA ABAZI

Perfaqesuar nga LULJETA ABAZI

Z. Abazi

BARDHYL CANAJ

B. Canaj



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 4752 Rep.

VERTETIM

Sot, ne Tirane, me date 02/Tetor 2003, para meje Liri Gjoliku, Notere prane Dhomes se Notereve Tirane u paraqiten personalisht ortaket e shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K. si me poshte:

- Bardhyl Canaj, shtetas shqiptar, I biri I Nimetit dhe I Vegulles, lindur me 29.08.1959, ne Tirane, banues ne adresen rruga 'Abdyl Frasheri ', Pall. 9, shk. 4, ap. 34, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,
- Luljeta Abazaj, e bija e Xheladinit dhe Subies, lindur me 29.07.1956, ne Tetove Maqedoni, mbajttese e pasaportes me Nr. 040858, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Per identitetin e te cileve u sigurova nga te dhenat e tyre personale, te cilet me deklaruan se vendimi i mesiperm i Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te kesaj Shoqerie u hartua me vullnetin e plote dhe te lire te tyre dhe une noterja i vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjit.

NOTERE

LIRI GJOLIKU

6684/3

3 M Depfo
25 TETOR 2004
SHQIPERISE



KERKESE

KERKUESI: Z. Bardhyl Canaj, shtetas shqiptar, i biri i Nimetit dhe I Vergulles, lindur me 29 Gusht 1959 ne Tirane, banues ne adresen Rruga "Abdyl Frasheri" Pall. 9, shk. 4, Ap. 34, Tirane, ne cilesine e Administratorit te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K.

OBJEKTI: Depozitimin e Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K., date 15.10.2004.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 7638, date 28 Nentor 1992, "Per Shoqerite Tregtare dhe Ligji Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin e Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare

Per kompetence Gjykates se Shkalles se Pare Tirane
Seksionjt Tregtar

Shoqeria RIO-FARMA Sh.P.K. eshte peson juridik shqiptar i regjistruar me vendimin nr. 6684 date 13.09.1993 te Gjykates se Shkalles se Pare. Shoqeria ka bere ndryshime me vendimin e gjyqtarot te vetem me Nr. 6684/1 date 07.10.2003.

Objekti i veprimtarise se shoqerise "RIO-FARMA" Sh.P.K. eshte si me poshte:

- Tregetimi me shumice dhe prodhimi i medikamenteve farmaceutike, import dhe eksport i tyre, paisje dhe instrumenta medicinale, sanitare, ushqime dietale per femije.

Selia e shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K. ndodhet ne adresen: Rruga e Saraceve, P. 112/1, Tirane, Shqiperi.


Kapitali i shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K. eshte 62.500.000 Leke (gjashtedhete e dy milion e peseqind mije Leke).

Ortaket e shoqerise jane Znj. Luljeta, Znj. Zamira Abazi dhe Z. Bardhyl Canaj.

Kontributi i secilit prej ortakeve ne kete kapital eshte :

- Znj. Luljeta Abazi e cila zoteron 25% te pjeseve te kapitalit ose e shprehur ne leke 15. 625. 000 Leke (pesembedhjete milion e gjashteqind e njetzet e pese mije leke).
- Znj. Zamira Abazi e cila zoteron 25% te pjeseve te kapitalit ose e shprehur ne leke 15. 625. 000 Leke (pesembedhjete milion e gjashteqind e njetzet e pese mije leke).
- Z. Bardhyl Canaj i cili zoteron 50% te pjeseve te kapitalit ose e shprehur ne leke 31 250 000 Leke (tridhjetete e nje milion e dyqind e pesedhjetete mije leke).

De depozitimi
Kerkesa
Asamblese
Tirane
2004
27/10/2004
Gjykatari



Ortakët e shoqërisë janë shprehur në mbledhjen e datës 15.10.2004 për rritje të kapitalit si rrjedhojë e rritjes së asetëve në aktiv të bilancit të shoqërisë. Qëllimi i rritjes së kapitalit është se shoqëria ka një rritje të aktivitetit të saj në vlerën e shitjeve, në asortiment dhe në klientelën e shitjes, shoqëria ka zgjerim të partneritetit të saj me furnitorët, është rritur fitimi neto i realizuar nga shoqëria dhe ky fitim nuk është shpërndarë duke realizuar rritjen e kapitalit, dhe janë rritur në mënyrë të ndjeshme aktivet e shoqërisë.

Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë është realizuar nëpërmjet kalimit në kapital të fitimit të pashpërndarë, kalimi në kapital i rezervës ligjore, konvertimi i kontributeve në natyrë të ortakëve në kapital.

Kështu bazuar në sa më lart me datë 15.10.2004, me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë, ortakët e kësaj shoqërie kanë vendosur:

1. Rritjen e kapitalit të shoqërisë "Rio - Farma" Sh.P.K.
2. Caktimin e Z. Ferdinand Nishani, shtetas shqiptar, ekspert kontabel i autorizuar, me Licencën Nr. 96, madhor me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, si ekspert për hartimin e raportit mbi rritjen e kapitalit të shoqërisë.....

Në përfundim, unë Kerkuesi në cilësinë e Administratorit të shoqërisë "Rio-Farma" SH.P.K. në bazë të Ligjit Nr. 7638, datë 28 Nëntor 1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", kërkoj që të bëhet depozitimi i Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "Rio-Farma" SH.P.K., datë 15.10.2004, në Zyren e Regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, duke kryer të gjitha ndryshimet përkatëse.

KERKUESI
Bradhyj Canaj



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 5143 Rep.

VERTETIM

Sot me daten 22.10 2004 para meje Liri Gjoliku, notere prane Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalisht perpara meje :

Bardhyl Canaj, shtetas shqiptar, i biri i Nimetit dhe I Vergulles, lindur me 29 Gusht 1959 ne Tirane, banues ne adresen Rruga "Abdyi Frasheri" Pall. 9, shk. 4, Ap. 34, Tirane, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ne cilesine e administratorit te shoqerise 'Rio-Farma' shpk, i cili me deklaroi se sa me siper eshte nje kerkese drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare Tirane per depozitimimin e Vendimit te Asamblese se shoqerise "Rio-Farma" SHPK, e hartuar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe Une, Noterja, e vertetoj ate rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

LIRI GJOLIKU

43



“Rio-Farma” sh.p.k
Rruga “Saraceve” (Shinasi Dishnica) Nr. 112/1
Tel : 221 958
Fax : 222 265



VENDIM

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE


Sot me daten 15/10/2004 u mbledh asambleja e ortakve te shoqerise “RIO-FARMA” shpk analizoj treguesit Ekonomiko-Financiare te bilancit per periudhen Janar – Dhjetor 2003:

VENDOSI

1. Rezerva Ligjore e Shoqeris ne vleren 71.991 Leke te kaloj per Ritjen e kapitalit themeltar ne kuoten 71.000 Leke.
2. Fitimi I mbetur prej 14.807.581 Leke te kaloj per Ritjen e Kapitalit Themeltar ne kuoten 14.800.000 Leke.
3. Blerja prej 43 m2 shtese magazine ne vleren 32.000 € e konvertuar ne leke 4.000.000 leke likujdimi i te ciles eshte bere nga kontributi I ortakve e ndare ne 2.000.000 Leke Z.BARDHYL CANAJ dhe 2.000.000 Leke nga Zj.LULJETA ABAZI.Ky kontribut te kaloj ne ritjen e Kapitalit Themeltar.
4. Ekspert Kontabel per Shtesen e Kapitali te jete Ferdinand Nishani.

ORTAKET E SHOQERIS “RIO-FARMA” SH.P.K

LULJETA ABAZI



ZAMIRA ABAZI
Perfaqesuar nga **LULJETA ABAZI**

BARDHYL CANAJ



99

VERTETIM

Sot, ne Tirane, me date 30 Tetor 2004, para meje Liri Gjolliku, Notere prane Dhomes se Notereve Tirane u paraqiten personalisht Ortaket e Shoqerise "Rio-Farma" sh.p.k si me poshte:

- Bardhyl Canaj, shtetas shqiptar, I biri I Nimetit dhe I Vegulles, lindur me 29.08.1959, ne Tirane, banues ne adresen rruga 'Abdyf Frasher' ,Pall. 9, shk. 4, ap. 34, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,
- Luljeta Abazaj, e bija e Xheladinit dhe Subies, lindur me 29.07.1956, ne Tetove Maqedoni, mbajtese e pasaportes me Nr. 040858, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,
- Znj. Zamira Abazaj, e bija e Zeqirias dhe Luljetes, perfaqesuar nga Znj. Luljeta Abazaj,

Per identitetin e te cileve u sigurova nga te dhenat e tyre personale, te cilet me deklaruan se vendimi i mesiperm i Asamblese se Ortakeve te kesaj Shoqerie u hartua me vullnetin e plote dhe te lire te tyre dhe une noterja i vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjit.


NOTERE

LIRI GJOLIKU

Liri

6684/2

J M Duge
10 10 2003
21 tetor 2003
KERRSE



KERKUESI: Z. Bardhyl Canaj, shtetas shqiptar, i biri i Nimetit dhe I Vergulles, lindur me 29 Gusht 1959 ne Tirane, banues ne adresen Rruga "Abdyl Frasherit" Pall. 9, shk. 4, Ap. 34, Tirane, ne cilesine e Administratorit te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K.

OBJEKTI: Depozitim e Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K., date 15.10.2003.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 7638, date 28 Nentor 1992, "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligji Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare".

Per kompetence

Gjykates se Shkalles se Pare Tirane
Seksionit Tregtar

Shoqesia RIO-FARMA Sh.P.K. eshte peson juridik shqiptar i regjistruar me vendimin nr. 6684 date 13.09.1993 te Gjykates se Shkalles se Pare. Shoqeria ka bere ndryshime me vendimin e gjyqtarot te vetem me Nr. 6684/1 date 07.10.2003.

Objekti i veprimtarise se shoqerise "RIO-FARMA" Sh.P.K. eshte si me poshte:

Tregtimi me shumice dhe prodhimi i medikamenteve farmaceutike, import dhe eksport i tyre, paisje dhe instrumenta medicinale, sanitare, ushqime dietale per femije.

Selia e shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K. ndodhet ne adresen: Rruga e Saraceve, P. 112/1, Tirane, Shqiperi.

Kapitali fillestar i shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K. eshte 10.000 USD (dhjete mije dollare amerikane) i cili i konvertuar me kursin e kohes eshte 1.000.000 Leke.

Ortaket e shoqerise jane:

- Znj. Luljeta Abazi.
- Znj. Zamira Abazi.
- Z. Bardhyl Canaj.

Me date 15.10.2003, me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, ortaket e kesaj shoqerie kane vendosur:

1. Pranimin dhe miratimin e raporteve te eksperteve Z. Ferdinand Nishani dhe Znj. Lirije Kruja per rritjen e kapitalit te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K ne vleren 61.500.000 Leke (gjashtedhjetë e nje milion e peseqind mije leke).

depozituar
Shoqesia RIO-FARMA Sh.P.K.
1/ Vendi ortakeve
at 15/10/2003
2/ Raport
at p. 10. 2003
3/ Raport
banam
23/10/2003

2. Qe nga ky moment kapitali i ri i shoqerise i regjistruar eshte : 61.500.000 leke plus kapitalin fillestar 1.000.000 leke i barabarte me 62 500 000 Leke (gjashtedhete e dy milion e peseqind mije leke).

Kontributi dhe pjeset qe zoterojne secili prej ortakeve ne kete kapital jane perkatesisht :

- Znj. Luljeta Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 15 625 000 Leke (pesedhete milion e gjashteqind e njezet e pese mije leke).
- Znj. Zamira Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 15 625 000 Leke (pesedhete milion e gjashteqind e njezet e pese mije leke).
- Z. Bardhyl Canaj do te zoteroje 50% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 31 250 000 Leke (tridhete e nji milion e dyqind e pesedhete mije leke).

3. Urdherimin e zyres se rregjistrimit tregtare per te depozituar vendimin e Asamblese se jashtezakonshme te ortakeve date 15.10. 2003, duke pasqyruar ndryshimet perkatese dhe konkretisht nenin 4 te statutit i cili do te shprehet ne kete menyre:

" Kapitali i shoqerise " Rio -Farma" shpk eshte 62. 500 .000 Leke (gjashtedhete e dy milion e peseqind mije Leke).

Kontributi i secilit prej ortakeve ne kete kapital eshte:

- *Znj. Luljeta Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 15. 625. 000 Leke (pesembedhete milion e gjashteqind e njezet e pese mije leke).*
- *Znj. Zamira Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 15. 625. 000 Leke (pesembedhete milion e gjashteqind e njezet e pese mije leke).*
- *Z. Bardhyl Canaj do te zoteroje 50% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 31 250 000 Leke (tridhete e nji milion e dyqind e pesedhete mije leke).*

Vlera nominale e nje kuote eshte 1000 leke .

Ne perfundim, une Kerkuesi ne cilesine e Administratorit te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K. ne baze te Ligjit Nr. 7638, date 28 Nentor 1992, "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare", kerkoj qe te behet depozitimi i Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Rio-Farma" SH.P.K., date 15. 10. 2003, ne Zyren e Regjistrimit Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, duke kryer te gjitha ndryshimet perkatese.

KERKUESI

Bradhyll Canaj



28

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 4987 Rep.

VERTETIM

Sot me daten 20.10 2003 para meje Liri Gjoliku, notere prane Dhomes se Notereve Tirane u paraqit personalisht perpara meje :

Bardhyl Canaj, shtetas shqiptar, i biri i Nimetit dhe I Vergulles, lindur me 29 Gusht 1959 ne Tirane, banues ne adresen Rruga "Abdyl Frasheri" Pall. 9, shk. 4, Ap. 34, Tirane, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ne cilesine e administratorit te shoqerise 'Rio-Farma' shpk, i cili me deklaroi se sa me siper eshte nje kerkese drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare Tirane per depozitimin e Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "Rio-Farma" SHPK, e hartuar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe Une, Noterja, e vertetoj ate rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

LIRI GJOLIKU



VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONESHME ORTAKEVE TE SHOQERISE

"RIO-FARMA" Sh. P. K.

Sot me date 15.10. 2003 u mbledh asambleja e ortakeve te shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K.

Shoqeria RIO-FARMA Sh.P.K. eshte peson juridik shqiptar i regjistruar me vendimin nr. 6684 date 13.09.1993 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

Objekti i veprimtarise se shoqerise RIO-FARMA eshte si me poshte:

- Tregetimi me shumice dhe prodhimi i medikamenteve farmaceutike, import dhe eksport i tyre, paisje dhe instrumenta medicinale, sanitare, ushqime dietale per femije.

Shoqeria ka bere ndryshime me Vendimin te gjyqtarit te vetem Nr. 6684/1 date 07.10.2003.

Selia e shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K. ndodhet ne adresen: Rruga e Saraceve,(Shenisi Dishnica) P. 112/1, Tirane, Shqiperi.

Kapitali fillestare i shoqerise RIO-FARMA Sh.P.K. eshte 10.000 USD (dhjete mije dollare amerikane) i cili i konvertuar me kursin e kohes eshte 1.000.000 leke .

Ortaket e shoqerise jane Znj. Luljeta, Znj. Zamira Abazi dhe Z. Bardhyl Canaj.

Administrator i shoqerise eshte Z. Bardhyl Canaj.

Pasi u konstatua pjesmarja e ortakeve si dhe e perfaqesuesve te tyre mbledhja e Asamblese se jashtezakonshme u quajt e hapur. Mbledhjen e jashtezakonshme te asamblese se ortakeve e drejtoi Z. Bardhyl Canaj. Ai kishte njoftuar me pare ortaket per rendin e dites tei cilet ishin njohur me te.


Fillimishte administratori i ri njoftoi ortaket se Gjykata e rrethit Tirane me vendimin e saj te dates 664/1 date 7.10.2003 ka miratuar disa ndryshime dhe ne te njejten kohe ka vendosur qe si eksperte te cilet do te vleresonin rritjen e kapitalit ishin caktuar Z. Ferdinand Nishani ekspert kontabel i autorizuar dhe Znj. Lirie Kruja eksperte per vleresimin e pasurive te palujsthme.

Pasi doli vendimi i gjykates se rrethit Tirane ekspertet realizuan detyrat e tyre dhe po paraqesin raportet e tyre para Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve

Pra rendi i dites se kesaj mbledhje eshte si me poshte:

1. Paraqitja nga ana e eksperteve e raportit te tyre per rritjen e kapitalit ne shoqerine " Rio- Farma " shpk

30

- 
2. Miratimi i rritjes se kapitalit te shoqerise "Rio-Farma" Sh.P.K nga Asambleja e Jashtezakonshme e ortakeve duke percaktuar vleren e kapitalit te rritur dhe kontributin e ortakeve ne kete kapital te rritur

Pasi u njohen me rendin e dites te pranishmit filluan diskutimet per cdo pike te tij.

Diskutime rreth rendit te dites.

Drejtuessi i mbledhjes Z. Bardhyl Canaj u spiegoi te pranishmeve se ne mbledhjen e mepareshme date 29.09.2003 ishte diskutuar rreth rritjes se kapitalit te shoqerise i cili ishte rritur tashme faktikisht ne vlere monetare dhe ne natyre. Per te vleresuar rritjen e kapitalit te shoqerise ne vendimin e meparshem te saj te dates 29.09.2003 shoqeria ka caktuar si ekspert Z. Ferdinand Nishani, i cili do te beje vleresimin e rritjes se kapitalit ne te holla dhe Znj. Lirije Kruja, e cila do te bente vleresimin e rritjes se kapitalit ne natyre.

Kerkesa e shoqerise per rritje te kapitalit ka ardhur si rrjedhoje e rritjes se asetave ne aktiv te bilancit te shoqerise. Rritja e aktivitetit te bilancit te shoqerise ka ardhur rrjedhoje e kontributeve te derdhura nga ortaket ne shoqeri ku nje pjese e tij eshte perdorur per blerje te pronave te paluajtshme ne emer te shoqerise "Rio-Farma" Sh.P.K dhe si rrjedhoje e kalimit te fitimit te pashperndare te shoqerise ne kapital.

Qellimi i rritjes se kapitalit eshte se shoqeria ka nje rritje te aktivitetit te saj , eshte rritur fitimi neto i realizuar nga shoqeria dhe ky fitim nuk eshte shperndare dke realizuar rritjen e kapitalit , dhe jane rritur ne menyre te ndjeshme aktivet e shoqerise.

Zmadhimi i kapitalit te shoqerise eshte realizuar nepermjet kalimit ne kapital te fitimit te pashperndare , kalimi ne kapital i rezerves ligjore , konvertimi i kontributeve te ortakeve ne kapital .Ky kapital eshte materializuar nga shoqeria duke blere kjo e fundit disa pasuri te paluajtshme te cilat jane dhene ne menyre te hollesishme ne aktin e ekspertimit nga ekspertja Lirije Kruja e cila ka bere ne menyre te detajuar vleresimin e tyre si :

Ambiente zyresh ne pallatin 11 katesh ne rrugen " Shenasi Dishnica" Tirane te cilat kapin nje vlere prej 156.000 USD

Bodrum i cilesuar me nr 1 ne pallatin 11 katesh ne rrugen " Shenasi Dishnica" Tirane i cili sipas vleresimit te ekspertes kap nje vlere prej 192.000 USD

Bodrum i cilesuar me nr 2 ne pallatin 11 katesh ne rrugen " Shenasi Dishnica" Tirane i cili sipas vleresimit te ekspertes kap nje vlere prej 92.400 USD

Perfundimishte pas nje shpjegimi te hollesishem te eksperteve ata arrine ne konkluzionin qe rritja e kapitalit te shoqerise eshte ne vleren 61.500.000 leke (gjatedhjete e nje milion e peseqind mije Leke).Kapitali fillestare i shoqerise ka qene 1.000.000 leke . Keshtu kapitali real i rregjistruar i shoqerise eshte 62. 500. 000 Leke (gjatedhjete e dy milion e peseqind mije Leke).

Ne aktin e ekspertimit ekspertet kane dhene ne menyrete detajuar kontributin e secilit prej ortakeve .Ortaku Bardhyl Canaj pervec kontributit te tij ka bere dhe drejtimin dhe menaxhimin e shoqerise .

Ne keto kushte ortaket bien plotesishte dakorte qe Bardhyl Canaj te zoteroje 50% te kapitalit dhe dy ortaket e tjere me nga 25% te kapitalit .Kete vendim ata e kane marre qe ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te ortakeve ne daten 29 .09.2003

Per shkak te kontributit te tij dhe meqenese ortaket kane rene dakort qe ortaku Bardhyl Canaj te zoteroje 50% te kapitalit te shoqerise "Rio – Farma" Sh.P.K. pjeset e kapitalit dhe vlefte e tij qe do te zoteroje secili prej tyre do te jete:

- a) Znj. Luljeta Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 15 625 000 Leke (pesembedhjete milion e gjashteqind e njezet e pese mije leke).
- b) Znj. Zamira Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 15 625 000 Leke (pesembedhjete milion e gjashteqind e njezet e pese mije leke).
- c) Z. Bardhyl Canaj do te zoteroje 50% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 31 250 000 Leke (tridhjete e nji milion e dyqind e pesedhjete mije leke).

2- Pasi degjuan ekspertet ortaket miratuan aktet e tyre te ekspertimit duke rene plotesishte dakorte qe kapitali i shoqerise te rritet me nje vlere prej 61.500.000 leke dhe duke shtuar dhe kapitalin fillestare prej 1.000.000 leke ky kapital te jete 62.500.000 leke.Gjithashtu ortakt jane plotesishte dakorte qe kontributi i tyre ne kete kapital te jete Luljeta Abazi 25% , Zamira Abazi 25% dhe Bardhyl Canaj 50% sipas vlerave te mesiperme te caktuara nga ekspertet .

Pas diskutimeve te mesiperme dhe duke mos patur ceshtje te tjera per te diskutuar ortaket e shoqerise:


VENDOSEN

1-Pranimin dhe miratimin e raporteve te eksperteve Z. Ferdinant Nishani, dhe Znj. Lirije Kruja per rritjen e kapitalit te shoqerise " Rio-Farma" shpk ne vleren 61.500.000 leke

2-Qe nga ky moment kapitali i ri i shoqerise i rregjistruar eshte :61.500.000 leke plus kapitalin fillestare 1.000.000 leke i barabarte me **62 500 000 Leke (gjatedhjete e dy milion e peseqind mije Leke).**

Kontributi dhe pjeset qe zoterojne secili prej ortakeve ne kete kapital jane perkatesisht:

- Znj. Luljeta Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 15 625 000 Leke (pesembedhjete milion e gjashteqind e njezet e pese mije leke).
- Znj. Zamira Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 15 625 000 Leke (pesembedhjete milion e gjashteqind e njezet e pese mije leke).



- Z. Bardhyl Canaj do te zoteroje 50% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 31 250 000 Leke (tridhjete e nji milion e dyqind e pesedhjete mije leke).

3-Urdherimin e zyres se regjistrimit tregtare per te depozituar vendimin e mesiperm te Asamblese se jashtezakonshme te ortakeve duke pasqyruar ndryshimet perkatese dhe konkretisht nenin 4 te statutit i cili do te shprehet ne kete menyre:

" Kapitali i shoqerise " Rio –Farma" shpk eshte 62. 500 .000 Leke (gjatedhjete e dy milion e peseqind mije Leke).

Kontributi i secilit prej ortakeve ne kete kapital eshte :

- *Znj. Luljeta Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 15. 625. 000 Leke (pesembedhjete milion e gjashteqind e njezet e pese mije leke).*
- *Znj. Zamira Abazi do te zoteroje 25% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 15. 625. 000 Leke (pesembedhjete milion e gjashteqind e njezet e pese mije leke).*
- *Z. Bardhyl Canaj do te zoteroje 50% te pjeseve te kapitalit te ri ose e shprehur ne leke 31 250 000 Leke (tridhjete e nji milion e dyqind e pesedhjete mije leke).*

Vlera nominale e nje kuote eshte 1000 leke .

Pasi nuk pati ceshtje te tjera per te diskutuar ortaket vendosen depozitim e ketij Vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane dhe e deklaruan mbledhjen e mbyllur.

ORTAKET E SHOQERISE "RIO-FARMA" SH.P.K

LULJETA ABAZI *L Abazi*

BARDHYL CANAJ

ZAMIRA ABAZI
Perfaqesuar nga LULJETA ABAZI

Z Abazi

VERTETIM

Sot, ne Tirane, me date ~~30~~ Tetor 2003, para meje Liri Gjoliku, Notere prane Dhomes se Notereve Tirane u paraqiten personalisht Ortaket e Shoqerise "Rio-Farma" sh.p.k si me poshte:

- Bardhyl Canaj, shtetas shqiptar, I biri I Nimetit dhe I Vegulles, lindur me 29.08.1959, ne Tirane, banues ne adresen rruga 'Abdyl Frasheri ',Pall. 9, shk. 4, ap. 34, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,
- Luljeta Abazaj, e bija e Xheladinit dhe Subies, lindur me 29.07.1956, ne Tetove Maqedoni, mbajtese e pasaportes me Nr. 040858, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,
- Znj. Zamira Abazaj, e bija e Zeqirias dhe Luljetes, perfaqesuar nga Znj. Luljeta Abazaj,

Per identitetin e te cileve u sigurova nga te dhenat e tyre personale, te cilet me deklaruan se vendimi i mesiperm i Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te kesaj Shoqerie u hartua me vullnetin e plote dhe te lire te tyre dhe une noterja i vertetoj nenshkrimet e tyre sipas ligjit.

NOTERE

LIRI GJOLIKU

R A P O R T

Per zmadhimin e kapitalit te shoqerise "RIO-FARMA" shpk.

Ne cilesine time si Ekspert Kontabel i Autorizuar i shoqerise suaj dhe ne zbatim te misionit te parashikuar nga neni 150 i ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", Ju paraqes raportin tim mbi projektin per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne shumen 62 500 000 leke, operacion per te cilin ka vendosur mbledhja e jashtezakonshme e ortakeve e mbledhur me date 20.09.2003.

Une kam proceduar ne kontrollin e informacioneve te dhena nga shoqeria per motivet e zmadhimit te kapitalit dhe menytrat e realizimit te tij.

Kam verifikuar gjithashtu ,informacionet e shifruara qe jane paraqitur duke kryer hapat qe i cmova te nevojshme sipas normave te profesionit.

Informacionet e shifruara te paraqitura nga shoqeria jane nxjrrre nga bilancet paraardhese te certifikuar nga EKA dhe nga nje gjendje e ndermjetme e hartuar me date 20.09.2003 ,e cila kjo e fundit ishte objekt i nje shqyrtimi te kufizuar nga ana ime,per arsye te nxjerrjes se nje bilanci te ndermjetem te pacertifikuar nga EKA.

Shoqeria "RIO-FARMA" shpk eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar me date 13.09.1993 dhe me kapital fillestar 1 000 000 leke.Ajo eshte themeluar prej dy ortakesh,me kontribute respektive:

| | | |
|---------------|--------------|-----|
| Zeqeria ABAZI | 900 000 leke | 90% |
| Bardhyl CANAJ | 100 000 leke | 10% |

I Motivet e zmadhimit te kapitalit

